

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Adoleshentja u zhduk pa gjurmë, shoqja e priftit të rremë nën hetim pas 40 vitesh
ADRESA	https://piranjat.al/bota/adoleshentja-u-zhduk-pa-gjurmë-shoqja-e-priftit-te-rreme-ne-hetim-pas-40-vi-i105943
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 21:27:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 21:16:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	7a9494b6efcb4bb790bf0472724f399fa591f1ca7d6a6296f393cd230a25aac6
TEKSTI	a38f2b245843e79fca60e3c3722cace5160c6aa3ebe1d92d959a4a574d5e801e
PAMJA	1e36417412ed857312c6b3a6935175267603ee2bdbabda547f6bc94ffff83462

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1458dd395a982a7b40d5face06cb2aa228399020d8c91839d7b6f5c7c96c64cd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8ee66351573ff093887d301c06da39468091241e63518e6f4ef2c25a699ab5e4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1458dd395a982a7b40d5face06cb2aa228399020d8c91839d7b6f5c7c96c64cd>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



[BOTA](#)

Flash: **Kama dhe Vlorë** arrestimit të ish-drejtoreshës së SHISH ■ **BE po e vëzhgon** së Shqipërisë (SHIS... ■ **floku dhe...?** Policia Shkencore, ka ■ **nxjerr "bllof"** Anila tërësisht historinë. Një ndjekje ■ **trupit i shqiptarit** nga natën mes të mërkurës dhe të ■ **kar** Shv

Adoleshentja u zhduk pa gjurmë, shoqja e priftit të rremë nën hetim pas 40 vitesh

Piranjat Përditësimi i fundit 24 Shtator 2026, 23:16



Pas Laura Casagrande dhe Marco Fassoni Accetti, tashmë del në skenë emri i një personi të tretë nën hetim në hetimin e ri të Prokurorisë së Romës për zhdukjen e Emanuela Orlandit. Bëhet fjalë për Gabriella Boggiani, ish-shoqe e Accetti, e njohur për hetuesit për shkak të një telefonate që ajo kreu së bashku me fotografën dhe kineastin romak, në vitin 1983. Ajo tashmë është 70 vjeç.

Dosje e ndryshme nga ajo e Accetti

"Po mësoj vetëm tani se jam nën hetim", tha ajo përpara Komisionit parlamentar dypalësh të hetimit për zhdukjen e Mirella Gregorit dhe Emanuela Orlandit. Kjo deklaratë konfirmohet edhe nga burime pranë Prokurorisë. Gruaja rezultoi nën hetim në një dosje të ndryshme nga ajo e Accetti, ku dyshohet se janë përfshirë edhe persona të tjerë, të gjithë pjesë e rrethit të njohjeve të fotografit në atë kohë, i cili në të kaluarën e kishte pranuar vetë se ishte përfshirë në rrëmbimin e Emanuela Orlandit.

"Unë nuk kam pasur kurrë frikë", tha Boggiani gjatë një seance me dyer të mbyllura. "Sigurisht, tani, pas asaj që është thënë këtu, unë nuk e dija se isha nën hetim dhe, disi, kam frikë."

Versioni i të dyshuarës së re

Boggiani sqaroi më pas episodin për të cilin emri i saj ishte përmendur edhe në disa rindërtime mediatike, të cilat madje kishin bërë që ajo të konsiderohej si një bashkëpunëtorë e dyshuar e Accetti. Sot, megjithatë, gruaja është distancuar prej tij, duke e përshkruar si një tip "të çuditshëm, pak të marrë", me të cilin nuk ka pasur më kontakte pas një njohjeje të rastësishme më shumë se 40 vjet më parë.

"Një ditë Accetti më tha: hajde, hajde, bëje këtë shaka – tregoje këtë telefonatë", ka rrëfyer ajo. "E bëra. Ishim në një kabinë telefonike në lagjen Africano", në Romë, "por pa menduar se kishte diçka të çuditshme. Unë nuk e dija as se kush ishte ky emër, kjo Orlandi. Ende nuk kishte ndodhur asgjë. Ai më tha: thuaj se ne e dimë se ku ndodhet Emanuela Orlandi, dhe kaq, mbaroi."

E pyetur më tej nga anëtarët e komisionit, ajo shtoi: "Konfirmoj se kam bërë një telefonatë, jo se kam lexuar një komunikatë", duke iu referuar pretendimit se gjatë asaj telefonate ishte lexuar një komunikatë ku kërkohej shkëmbimi i Emanuelës me terroristin turk Ali Agca.

Dyshimet mbi fotografën

Prej një kohe të gjatë, si Komisioni, ashtu edhe Prokuroria po përpiqen të rishqyrtojnë me kujdes episode dhe aspekte që në të kaluarën nuk janë hetuar në thellësi dhe që lidhen me Accettin, i cili tashmë është nën hetim në bashkëpunim me persona ende të paidentifikuar për rrëmbimin me qëllim zhvatjeje të Mirella Gregorit dhe Emanuela Orlandit.

Përveç rastit të 15-vjeçares, shtetase e Vatikanit, vëmendja është zgjeruar edhe te vdekja e 13-vjeçarit José Garramon, i cili u gjet i pajetë në dhjetor të të njëjtit vit në pyllin me pisha të Castel Porziano. Pikërisht Accetti e përplasi me automjetin dhe më pas u dënua përfundimisht vetëm për vrasje nga pakujdesia, ndërsa sot hetuesit po shqyrtojnë mundësinë që të mos ketë qenë një aksident i thjeshtë.

Në lidhje me këtë çështje, javën e kaluar u dëgjua nga Komisioni edhe nëna e Josés, Maria Laura Bulanti, e cila e njohu Accettin si "priftin e rremë" që ishte paraqitur në shtëpinë e saj pak para zhdukjes së të birit.

Nërkohë, Njësia e Hetimeve Shkencore e Karabinierëve (RIS) po kryen ekspertizë të reja gjenetike mbi flautën që Accetti i dorëzoi Prokurorisë në kohën kur pranoi vetë se ishte i përfshirë në zhdukjen e Emanuela Orlandit. Tashmë priten me interes rezultatet e këtyre analizave. /PiranjatNews/

Artikuj te sugjeruar

BOTA 24 Shtator22:57

Mamdani sulmon Netanyahu pas fjalimit në OKB: Gënjeshtër të pabaza për të justifikuar veprimet ndaj palestinezëve

Kryetari i Bashkisë së Nju Jorkut, Zohran Mamdani, iu përgjigj fjalimit të Kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu në OKB, i cili pë...

BOTA 24 Shtator22:25

“Putin është në një pozitë të keqe”, Rutte qetëson aleatët e NATO-s pas raporteve të kërcënimeve

NATO është e përgatitur t’i përgjigjet incidenteve të sabotimit dhe dronëve në të gjithë Evropën dhe ka ...

BOTA 24 Shtator22:02

Senati amerikan hedh poshtë rezolutën që kufizon fuqitë e Trumpit në luftën kundër Iranit

Senati i SHBA-së hodhi poshtë me një diferencë të ngushtë votash të enjten një rezolutë të udhëhequr nga ...

BOTA 24 Shtator21:33

Protesta masive në New York kundër Netanyahu, mbi 100 persona të arrestuar

Qindra protestues u mbledhën të enjten pranë selisë së OKB-së në New York, në shenjë kundërshtimi ndaj kryemin...

BOTA 24 Shtator21:32

Po mbante fjalimin, Netanyahu përballët me largimin e diplomatëve në OKB

Dhjetëra delegatë u larguan nga salla e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, ndërsa kryem...

BOTA 24 Shtator21:02

“Përdor substanca të ndaluara”, Zakharova lëshon akuza të forta ndaj Zelenskyt

Përplasja verbale mes Moskës dhe presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky është ashpërsuar pas deklaratës së tij se në kr...

BOTA 24 Shtator20:52

VIDEO/ Presidenti i Haitit pi ujë me kanë në mes të OKB-së

Presidenti i Haitit, Edgar Leblanc Fils është bërë një “yll i memeve” në orët e fundit pas një gabimi epik g...

BOTA 24 Shtator20:32

NATO gati të përgjigjet ndaj sulmeve hibride ruse/ SHBA kërkon më shumë përgjegjësi nga Evropa

NATO është e përgatitur të përgjigjet ndaj sulmeve hibride dhe akteve të sabotazhit që synojnë vendet evropiane, ka dekl...

BOTA 24 Shtator20:25

SHBA-ja mund të ndërmarrë veprime ushtarake ndaj Kanadasë/ Carney: Do të ishte e papërgjegjshme të mos përgatiteshim

Kryeministri kanadez Mark Carney ka deklaruar se qeveria e tij ka shqyrtuar edhe mundësinë e një veprimi ushtarak amerikan kundër Kanadasë...

BOTA 24 Shtator19:48

Xi i drejtohet Trumpit: Le të bashkëjetojmë në paqe, konkurrenca duhet të ketë kufij

Pekini dhe Uashingtoni duhet të “forcojnë komunikimin e tyre”, tha Presidenti kinez Xi Jinping, duke theksuar nga Shtëpia e Bardhë...

ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 24 Shtator

EMRAT/ 63-vjeçari i intubuar të Trauma. Çfarë n...

Një ngjarje e rëndë e ndodhur më 16 shtator në Sarandë, e cila nuk ishte bërë publike më herët, ka përfun...

AKTUALITET 24 Shtator

Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni...

Policia greke ka zhvilluar një aksion në Selanik, ku ka arrestuar tre shtetas shqiptarë të dyshuar për përfshirje në një...

AKTUALITET 24 Shtator

[EMRI/ Ra në gropën e ashensorit dhe vdiq, si u...](#)

Altin Kokici, një 51-vjeçar me origjinë shqiptare, është gjetur i vdekur natën mes të mërkurës dhe të enjtes...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

[EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja “mbysin” Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro](#)


Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

video




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1






PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1




“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit





Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.